

ABSTRAKTI I TEMËS SË DIPLOMËS
“NDIKIMI I PANDEMISË COVID – 19 NË RRRITJEN E BORXHIT PUBLIK NË
SHTETET E BALLKANIT PERËNDIMOR”

Mentor:

Prof. Dr. Bedri Peci

Kandidati

Arlind Tahiri

Abstrakti

Ekonomia botërore vazhdon të jetë e sfiduar nga pasojat që pandemia COVID – 19 ka shkaktuar dhe vazhdon të shkaktojë në të gjitha sferat e jetës, e sidomos në zhvillimin ekonomik të vendeve veç e veç, por edhe ekonomisë globale në përgjithësi. Në fillim të vitit 2020 të gjitha shtetet u gjendën të papërgatitura ndaj një sfide të madhe, tërësisht të panjohur dhe padyshim krizën më të madhe shëndetësore globale për shekullin XXI. Secili shtet kishte miratuar një buxhet për vitin fiskal 2020, mirëpo asnjëri prej tyre nuk kishte planifikuar as mjete shtesë për tu përballur me pandeminë COVID – 19, e padyshim as nuk prisnin një karantinë thuajse 3 mujore në nivel lokal, shtetëror e global, që përveç izolimit solli edhe pezullimin thuajse të përgjithshëm të ekonomisë globale, duke shkaktuar ndër të tjera edhe mungesën e të hyrave të planifikuara për buxhetet e shteteve dhe organizatave buxhetore. Shtetet e Ballkanit Perëndimor ishin ndër më të prekurat në Evropë, kjo sepse ato janë edhe me fuqinë ekonomike më të ulët, dhe vazhdojnë të mbajnë statusin e vendeve në zhvillim, andaj dhe fuqia e tyre ekonomike është më e ulët se e vendeve të tjera të Evropës. Të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor u desh të ri-planifikonin jo thjesht shpenzimet, por edhe të hyra në buxhetet e tyre të vitit 2020, e madje edhe të vitit 2021, për rrjedhojë dhe vitet më pas vazhdojnë të ndikohen nga pasojat e pandemisë COVID – 19. Në mungesë të të ardhurave (të hyrave) buxhetore, në përgjigje të rritjes së shpenzimeve si dhe nevojës për mbijetesë dhe rimëkëmbje ekonomike, shtetet e Ballkanit Perëndimor u detyruan të rrisin borxhin publik, duke marrë hua nga jashtë, me qëllim të përmbushjes së nevojave të ekonomisë së shteteve të tyre. Secili shtet ka pasur specifikat e tij, por në tërësi objekt i analizës së këtij punimi do të jenë shtetet e Ballkanit Perëndimor, të cilat rritën buxhetin publik në mënyrë të theksuar duke u nxitur nga nevojat e shkaktuara për shpenzime shtesë dhe nga ulja e të ardhurave, ashtu që në situatë të pakësimit të të ardhurave dhe rritjes së shpenzimeve, zgjidhja e vetme ishte rritja e borxhit publik.

Fjalë kyçe: Buxheti, borxhi, ekonomia, pandemia, Ballkani Perëndimor